



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 1 / 058

Datë 08 / 10 / 2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-228 që e përfaqëson: Muhadin Halili ,
Drejtor i Prokurimit në njëren anë:

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik BRAHIM ZEQIRI B.I.; ADA GROUP SH.A., Hajdar Dushi 14,
10000, PRISHTINË, Kosovë që e përfaqëson *Arsim Zeqiri* nr. i tel.049-102-509 në anën tjetër,
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Marrëveshje kornizë 12 muaj Furnizim me pemë dhe perime

Numri i Prokurimit AQP-19-011-111

Numri i Brendshëm i Prokurimit UA/2016-19-9623-1-1-1

Numri i Mini-tenderit 617-20-5757-5-5-8

Numri i Brendshëm i Prokurimit 617-2020-070-136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

Marrëveshje kornizë 12 muaj Furnizim me pemë dhe perime

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 08.10.2020 dhe përfundon me 08.10.2021

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *dy* ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i *dërgimit të furnizimeve* do të jetë : *Qerdhja e Fëmijëve dhe Shtëpia Rezidenciale.*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 6,444.00 €
(Gjashtëmijë e katërqindë e katërdhjetë e katër euro)

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë (Faturë) nga OE dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitorohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet t'i kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë

me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kerkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arsim Zeqiri	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.10.2020	Data:	08.10.2020
Vula:		Vula:	


DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE - SHTIME
SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE -SHTIME
Specifikacion për Pemë dhe Perime për nevojat e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime

Nr.	Përshkrimi : Artikulli	Nj.matëse.	Sasia e	Çmimi për	Shuma
			planifiku ar për një vit	njësi	
1	Avokado	Kg	5	€ 1.00	€ 5.00
2	Ananas	kg	20	€ 1.00	€ 20.00
3	Banane të freskëta	kg	200	€ 1.00	€ 200.00
4	Domate e freskët	kg	250	€ 0.85	€ 212.50
5	Dardha të freskëta	kg	60	€ 1.00	€ 60.00
6	Grosh e bardhë	kg	100	€ 1.90	€ 190.00
7	Hudhra	kg	3	€ 3.00	€ 9.00
8	Karrota	kg	20	€ 0.60	€ 12.00
9	Kivi	Pak	50	€ 1.20	€ 60.00
10	Kumbulla të freskëta	kg	50	€ 0.30	€ 15.00
11	Kajsi	Kg	15	€ 0.40	€ 6.00
12	Limon	kg	30	€ 1.30	€ 39.00
13	Lakra të freskëta	kg	500	€ 0.25	€ 125.00
14	Mandarina të freskëta	kg	100	€ 0.85	€ 85.00
15	Molla të freskëta	kg	100	€ 0.80	€ 80.00
16	Patate të freskëta	kg	400	€ 0.25	€ 100.00
17	Pjeshka të freskëta	kg	60	€ 0.70	€ 42.00
18	Portokaj të freskët	kg	100	€ 1.00	€ 100.00
19	Purri të freskët	kg	40	€ 0.60	€ 24.00
20	Pjeper	Kg	60	€ 0.70	€ 42.00
21	Qepë	kg	200	€ 0.35	€ 70.00
22	Qershi	Kg	30	€ 1.00	€ 30.00
23	Rrush i freskët	kg	80	€ 0.80	€ 64.00
24	Specë të freskët	kg	300	€ 1.00	€ 300.00
25	Shalqin i freskët	kg	100	€ 0.10	€ 10.00
26	Spinaq i freskët	kg	40	€ 0.30	€ 12.00
27	Shega	Kg	10	€ 3.00	€ 30.00
28	Tranguj të freskët	kg	250	€ 0.80	€ 200.00
29	Xhenxhefil	Kg	5	€ 4.00	€ 20.00
30	Dredhëz	kg	40	1.2	€ 48.00
				Totali :	€ 2,210.50




Për furnizim me pemë dhe perime në I.P 'Albiona Asllani'- Shtime

	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	çmimi për nj	Shuma në €
1	Pasul	kg	200	€ 1.90	€ 380.00
2	Patate	kg	300	€ 0.25	€ 75.00
3	Baby patate	kg	50	€ 0.40	€ 20.00
4	Patate e ëmbël	kg	10	€ 0.20	€ 2.00
5	Bizele	kg	20	€ 1.00	€ 20.00
6	Bushtaja	kg	20	€ 1.00	€ 20.00
7	Lakër e bardhë	kg	100	€ 0.25	€ 25.00
8	Lakër e kuqe	kg	50	€ 0.50	€ 25.00
9	Sallatë e gjelbërt	copë	200	€ 0.30	€ 60.00
10	Domate	kg	400	€ 0.85	€ 340.00
11	Domatina	kg	50	€ 2.00	€ 100.00
12	Trançuj normal	kg	150	€ 0.85	€ 127.50
13	Trançuj të vegjël	kg	100	€ 0.40	€ 40.00
14	Qepë e bardhë	kg	100	€ 0.35	€ 35.00
15	Qepë e kuqe	kg	50	€ 0.70	€ 35.00
16	Speca të kuq (të ajvarit)	kg	50	€ 0.80	€ 40.00
17	Speca të gjelbërt (të gjatë)	kg	50	€ 1.00	€ 50.00
18	Speca sombor (pa djegës)	kg	50	€ 0.50	€ 25.00
19	Speca babure (pa djegës)	kg	50	€ 1.00	€ 50.00
20	Karrota	kg	100	€ 0.60	€ 60.00
21	Limon	kg	30	€ 1.30	€ 39.00
22	Dardhë (sipas stinës)	kg	300	€ 1.20	€ 360.00
23	Banane	kg	250	€ 1.20	€ 300.00
24	Dredhëza	kg	50	€ 1.30	€ 65.00
25	Shalqin	kg	50	€ 0.10	€ 5.00
26	Pjepër	kg	50	€ 0.30	€ 15.00
27	Mandarinë	kg	150	€ 0.85	€ 127.50
28	Portokall	kg	200	€ 0.85	€ 170.00
29	Kivi	kg	100	€ 1.20	€ 120.00
30	Mollë e verdhë	kg	100	€ 0.80	€ 80.00
31	Mollë e gjelbërt	kg	100	€ 0.80	€ 80.00
32	Mollë e kuqe	kg	100	€ 0.80	€ 80.00
33	Rrush i bardhë	kg	100	€ 1.00	€ 100.00
34	Rrush i zi (Hamburg)	kg	100	€ 0.60	€ 60.00
35	Spinaq	kg	50	€ 0.25	€ 12.50
36	Lulelakër	kg	15	€ 0.40	€ 6.00



37	Patëllgjan i zi	kg	15	€ 1.30	€ 19.50
38	Rrepë e kuqe	kg	15	€ 0.60	€ 9.00
39	Brokoli	kg	15	€ 1.30	€ 19.50
40	Këpurdha të freskëta	kg	50	€ 2.00	€ 100.00
41	Asparagus (shparguj)	kg	10	€ 0.40	€ 4.00
42	Rukola (100gr)	kufi	50	€ 1.00	€ 50.00
43	Presh	kg	20	€ 0.60	€ 12.00
44	Kungulleshë	kg	50	€ 1.30	€ 65.00
45	Magdanoz	tuba	100	€ 0.30	€ 30.00
46	Pjeshkë	kg	150	€ 1.00	€ 150.00
47	Nektarinë	kg	150	€ 1.10	€ 165.00
48	Shegë	kg	100	€ 1.30	€ 130.00
49	Kumbulla	kg	200	€ 0.40	€ 80.00
50	Qershí	kg	100	€ 1.30	€ 130.00
51	Vidim	copë	10	€ 0.40	€ 4.00
52	Kungull për pite	copë	15	€ 0.40	€ 6.00
53	Limë (l imon i gjelbërt)	kg	5	€ 1.00	€ 5.00
54	Gështenja	kg	50	€ 1.30	€ 65.00
55	Qepë e njomë	tuba	100	€ 0.10	€ 10.00
56	Hudhër	kg	10	€ 3.00	€ 30.00
Gjithësej Totali					€ 4,233.50

Gjithësej Totali: Shtëpia e Komunitetit dhe Qerdhja	€ 6,444.00
--	-------------------

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	BRAHIM ZEQIRI B.I&ADA GROUP SH.A
ADRESA E PLOTE	HAJDAR DUSHI 14 PRISHTINE
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	BRAHIM ZEQIRI
POZITA	PRONAR
NËNSHKRIMI	
DATA	01.09.2020
VULA	

